



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

---

Numri i lëndës: 2021:197202

Datë: 03.11.2022

Numri i dokumentit: 03605242

**C. nr. 101/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore, të paditëses - kundër të paditues M. P. nga ....., të cilën me autorizim e përfaqëson S.S., avokat nga Kamenica, kundër të paditurit – kundërpaditësit N. D. nga ....., të cilin me autorizim e përfaqëson Y. H. avokat nga Gjilani, me objekt kontesti për vërtetimin e së drejtës së pronësisë, jashtë seancës gjyqësore, më datën 03.11.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET se është tërhequr** kundërpadia me numër C. nr. 101/2019, e datës 22.11.2019, e të paditurit – kundërpaditësit N. D. nga ....., e parashtruar kundër paditëses – kundër të paditues M. P. nga ....., e paraqitur kundër të, për vërtetimin e së drejtës së pronësisë.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale të shkaktuara sipas kundërpadisë të të paditurit.

**A r s y e t i m**

Paditësja M. P. nga ....., përmes të autorizuarit të saj S. S., avokat nga Kamenica, me datën 12.07.2019, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit N. D. nga ....., me objekt kontesti për lirimin e shtëpisë me pronën e paluajtshme, me vlerë të kontestit prej 31.800.00 euro. Ndërsa i padituri N. D. nga ....., më datën 22.11.2019, në këtë gjykatë, kundër paditëses M. P. nga ....., ka parashtruar kundërpadi, për vërtetimin e së drejtës së pronësisë.

I autorizuari i kundërpaditësit avokati Y. H. nga Gjilani, përmes parashtresës të datës 03.11.2022, të dorëzuar në këtë gjykatë, e ka njoftuar gjykatën se e ka tërhequr kundërpadinë e të paditurit - kundërpaditësit N. D. nga ....., të paraqitur ndaj paditëses – kundër të paditues M. P. nga ....., me numër C. nr. 101/2019, të datës 22.11.2022, për vërtetimin e së drejtë së pronësisë, me arsyetimin se palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore lidhur me çështjen e cila është objekt i kontestit.

Gjykata duke e pasur parasysh faktin se i autorizuari i paditëses avokati Y.H. nga Gjilani, e ka tërhequr kundërpadinë me numër C. nr. 101/2019, të datës 22.11.2019, si dhe faktin se i autorizuari i paditësit avokati S. S. nga Kamenica, e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e kundërpadisë dhe nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, konform dispozitës së nenit 261 paragrafi 2 të LPK-së vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga të lartëcekurat, e konform nenit 261 paragrafi 2, 3 dhe 4, e lidhur me nenin 387 paragrafi 1, pika c, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**

**C. nr. 101/2019, i datës 03.11.2022**

**G j y q t a r i**

**Artan Abazi, d. v**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Bazuar në nenin 261.4 të LPK-së, kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.